



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 6578/prot.

Tiranë, më 16. 12 2022

URDHËR

Nr. 674, Datë 16.12.2022

**“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË
NOTERIT ALEKO ANAGNOSTI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrit nr. 596 datë 11.11.2022, të Ministrit të Drejtësisë, është vendosur pezullimi i përkohshëm nga detyra i noterit Aleko Anagnosti, referuar nenit 56, gërma “a”, e Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të noterit z. Aleko Anagnosti, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e noterit, si dhe marrjen në dorëzim të vulës së thatë dhe të njomë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë përgjatë periudhës së pezullimit.

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të emailit datë 13.12.2022 të Degës Vendore të Noterisë Gjirokastër,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të noterit z. Alek Anagnosti, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Hyri Ramaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Z. Andi Përmeti, përgjegjës Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;

d.) Z. Krenar Abazi, përfaqësues nga Dega Vendore e Noterisë Gjirokastër.

2. Noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.
3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.
4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterit të Degës Vendore të Noterisë Gjirokastër **z. Edvin Kolagji**, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noterial noterit **z. Edvin Kolagji**, si dhe marrjen në dorëzim të vulës së thatë dhe të njomë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, përgjatë periudhës së pezullimit.
7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës si dhe noterit Aleko Anagnosti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

